

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Profilin Mësimor**

**KUZHINË - PASTIÇERI**

**Niveli II**

**(Në drejtimin mësimor HOTELERI - TURIZËM)**

**Kodi: G2-II-18**

Miratoi:

MINISTRI

**Tiranë, 2018**

## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, të drejtimit mësimor “Hoteleri-Turizëm”.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II.**

1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II.

**III. Plani mësimor për profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II,**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, të drejtimit “Hoteleri- Turizëm”.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, të drejtimit “Hoteleri-Turizëm”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet në kuzhinë dhe pasticeri.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profili “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Hoteleri-Turizëm”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të kryejë procese parapërgatitore në kuzhinë dhe pastiçeri
- Të bëjë ndarjen anatomike të mishit.
- Të gatujë bulion të kthjellët, me shpendë, peshk .
- Të përgatit salcë të errët bazë .
- Të përgatisë salcë të bardhë dhe beshamel.
- Të përgatisë brumë sfoljat dhe asortimente.
- Të gatujë asortimente me brumra.
- Të gatujë asortimente tradicionale shqiptare dhe ndërkombëtare.
- Të përgatisë shurupë, kisele, zhele, marmelata, prevede, gliko.
- Të përgatisë kremra të ftohtë dhe me zjerje
- Të përgatisë fondan, çokolatë, karamel, prodhime sheqeri (konfeteri).
- Të përgatisë asortimente me bazë brumi në pastiçeri.
- Të përgatisë asortimente të menuve për bankete të zakonshme dhe festive.
- Të përgatisë asortimente të menuve për pritje të zakonshme dhe festive.
- Të dallojë llojet dhe veçoritë e shërbimeve speciale në restorant dhe bar.
- Të dekorojë ushqimet në kuzhinë dhe pastiçeri sipas rregullave të estetikës.
- Të zbatojë elementet e marketingut në veprimtarinë e kuzhinës dhe pastiçerisë.
- Të zbatojë rregullat e higjienës në veprimtarinë e kuzhinës dhe pastiçerisë;
- Të zbatojë rregullat etikës dhe estetikës në veprimtarinë e kuzhinës dhe pastiçerisë;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në veprimtarinë e kuzhinës dhe pastiçerisë;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike në veprimtarinë e veprimtarinë e kuzhinës dhe pastiçerisë;
- Të mirëmbajë mjetet dhe mjedisin e punës;

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës si kuzhinier dhe si pastiçier në restorante dhe pastiçeri të ndryshme në industrinë e mikpritjes.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>8/9</b> (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>7 (238)</b>
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-13-165-10	Ushqim	2
3	L-13-166-10	Elemente të marketingut të turizmit	1
4	L-13-167-10	Estetika dhe shërbimet speciale në restorant dhe bar	2
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>12</b> (408)
1	M-13-435-10	Përgatitja dhe gatimi i asortimenteve bazë në kuzhinë	69
2	M-13-436-10	Gatimi i asortimenteve të kuzhinës shqiptare dhe ndërkombëtare	69
3	M-13-437-10	Përgatitja e produkteve bazë dhe asortimenteve të pastiçerisë	201
4	M-13-438-10	Gatimi i asortimenteve për pritje dhe bankete	69
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar</b> (Gjithsej)	<b>3</b> (102)
1	M-13-439-10	Gatimi i bukës dhe asortimenteve të saj në kuzhinë	102

2	M-13-433-10	Komunikimi efektiv në shërbimet hoteliere	51
3	M-13-434-10	Llogaritje të kostos dhe të çmimit në hoteleri	51
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31</b> (1020/ 1054)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Kuzhinë-Pastiçeri”.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Kuzhinë-Pastiçeri”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ **Bazat e sipërmarrjes**”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të analizojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të menaxhimit në biznes
- Të shpjegojnë se si funksionon tregu
- Të shpjegojnë veprimtaritë kryesore të bankave të niveleve të dyta
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër "P"-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit ë punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 - 68 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
<b>Tema 2</b>	Kërkimi sipërmarrës dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
<b>Tema 3</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
<b>Tema 4</b>	Menaxhimi dhe organizimi i punës në biznes	10 orë
<b>Tema 5</b>	Tregu	7 orë
<b>Tema 6</b>	Paraja, bankat dhe krediti	7 orë
<b>Tema 7</b>	Njohuri për marketingun	5 orë
<b>Tema 8</b>	Legjislacioni dhe etika e biznesit	6 orë
<b>Tema 9</b>	Legjislacioni i punës	7 orë
<b>Tema 10</b>	Llogaritje të thjeshta ekonomike	9 orë
<b>Tema 11</b>	Aspekte të TIK-ut në biznes	2 orë



## 2. Lënda “Ushqim” ( L-13-165-10). Kl. 12 – 68 orë

### • Synimet e lëndës “Ushqim”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ushqim”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të tregojnë kuptimin e ushqimit dhe rëndësinë e tij në jetën e njeriut.
- Të shpjegojnë evolucionin e konsumit të ushqimeve.
- Të shpjegojnë faktorët që ndikojnë në sjelljen ushqimore.
- Të dallojnë autoritetet shqiptare dhe europiane të sigurisë ushqimore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e ligjit shqiptar për sigurinë ushqimore.
- Të përshkruajnë sipas ligjit rolin e etiketimit dhe ambalazhimit të produkteve ushqimore.
- Të zbatojnë logjikën e të ushqyerit në aspektin sasior dhe cilësor.
- Të shpjegojnë asimilimin e ushqimit bazuar në aparatën tretës.
- Të dallojnë përqindjen në peshë të elementëve përbërës kryesorë të organizmit të njeriut.
- Të shpjegojnë funksionin e elementëve përbërës kryesorë të organizmit të njeriut.
- Të dallojnë përbërësit kryesorë të ushqimeve (kabo-hidrate, yndyrna, proteina, enzima, vitamina, minerale, uji etj.) dhe funksionin apo rolin e tyre në organizëm, sipas llojit duke treguar veçoritë e tyre.
- Të dallojnë burimet ushqimore të përbërësve të ushqimit si dhe efektet e tepicës apo mungesës së tyre në organizëm.
- Të dallojnë ndikimin e kripës së kuzhinës në organizmin e njeriut.
- Të përshkruajnë zbrërthimin e alkooleve në organizëm duke nxjerrë në pah efektet negative të tij.
- Të klasifikojnë ushqimet në grupe sipas funksionit dhe rolit të tyre në organizëm.
- Të shpjegojnë kuptimin mbi bilancin energjetik.
- Të llogarisin energjinë e çliruar nga produkte ushqimore të thjeshta apo të përpunuara.
- Të llogarisin shpenzimin e energjisë në organizëm mbi bazën e treguesve individualë dhe të aktivitetit.
- Të përcaktojnë nevojat kalorike totale individuale sipas veprimtarisë.
- Të përcaktojnë treguesit bazë për ndërtimin e dietave ushqimore ideale në përputhje me veçoritë individuale dhe parimet e higjenes së ushqimit.
- Të llogarisin dieta ushqimore të studiuara, duke pasur parasysh nevojat kalorike totale sipas veçorive individuale dhe veprimtarive.
- Të llogarisin peshën ideale, duke pasur parasysh faktorë individuale.
- Të ndërtojnë dieta të ekuilibruara.
- Të përdorin në mënyrë korrekte informacionin në lidhje me nivelin e rekomanduar të marrjes së ushqimeve.
- Të llogaritën nevojat e popullatës për ushqim sipas vakteve dhe përbërësve të ushqimit.
- Të vlerësojnë situatën e të ushqyerit si për individë të veçantë, ashtu edhe për grupe homogjene.
- Të dallojnë lidhjen e ushqimit me shëndetin.
- Të dallojnë ndikimin e kequshqyerjes në shëndet.
- Të përcaktojnë dieta dhe sjellje ushqimore për të sëmurë me obezitet, diabet, sëmundje kardiovaskulare, arteriosklerozë, hipertension, tumore, anoreksi dhe bulimi, alergji dhe intolerancë nga ushqimet.
- Të analizojnë rolin e mass-medias, reklamës dhe edukimit ushqimor në zgjedhjen ushqimore.
- Të ndërtojnë modele të reklamave për prezantimin e produkteve ushqimore.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ushqim”, kl. 12 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Ushqimi, evolucioni i konsumit të ushqimeve dhe sjellja ushqimore.	6 orë
<b>Tema 2</b>	Siguria ushqimore.	6 orë
<b>Tema 3</b>	Përbërësit e ushqimeve, funksioni në organizëm.	6 orë
<b>Tema 4</b>	Ushqimi dhe të ushqyerit.	6 orë
<b>Tema 5</b>	Bilanci energjetik dhe peshat ideale	15 orë
<b>Tema 6</b>	Ushqimi i ekuilibruar.	12 orë
<b>Tema 7</b>	Dieta dhe dietoterapia.	10 orë
<b>Tema 8</b>	Mass-media, reklama dhe edukimi ushqimor.	7 orë

### **3. Lënda “Elemente të marketingut të turizmit” (L-13-166-10). Kl. 12 – 34 orë**

- **Synimet e lëndës “Elemente të marketingut të turizmit”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës ”Elemente të marketingut të turizmit” kl, XII, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin dhe historinë e zhvillimit të marketingut.
- Të dallojnë ndikimin e marketingut në zhvillimin ekonomik në përgjithësi.
- Të dallojnë dhe argumentojnë me shembuj ndikimin e marketingut në sektorin e turizmit.
- Të shpjegojnë funksionet e marketingut.
- Të shpjegojnë veçoritë e tregut turistik dhe mënyrat e segmentimit të tij.
- Të dallojnë instrumentet e marketingut që përdoren për studimin e tregut turistik.
- Të shpjegojnë veçoritë e ofertës turistike.
- Të dallojnë mënyrat e analizës, zhvillimit dhe strategjisë së ofertës turistike.
- Të shpjegojnë kuptimin mbi produktin turistik duke mbajtur parasysh dallimet mes të mirave dhe shërbimeve.
- Të dallojnë kuptimin mbi politikën kryesore të çmimeve në sektorin e turizmit.
- Të shpjegojnë metodat e shitjes në hoteleri duke mbajtur parasysh elementet e përhapjes së informacionit, sistemeve të rezervimit.
- Të dallojnë kuptimin për shitjet në sektorin e gastronomisë, hoteleri dhe agjenci turistike.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe rolin e reklamës në turizëm.
- Të dallojnë me shembuj ndikimin e reklamës në sektorin e shërbimeve turistike.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Elemente të marketingut të turizmit”, kl. 12 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Hyrje në marketing. Ndikimi i marketingut në zhvillimin ekonomik.	2 orë
<b>Tema 3</b>	Funksionet e marketingut, tregu turistik dhe segmentimi i tij.	6 orë
<b>Tema 4</b>	Instrumentet e marketingut për studimin e tregut turistik.	4 orë
<b>Tema 4</b>	Kuptimi mbi ofertën turistike.	4 orë
<b>Tema 5</b>	Kuptimi i produktit turistik.	4 orë
<b>Tema 7</b>	Politikat e çmimeve në sektorin e shërbimeve turistike.	3 orë
<b>Tema 8</b>	Metodat e shitjes në hoteleri	2 orë
<b>Tema 9</b>	Shitjet në gastronomi, hoteleri, agjenci udhetimesh.	4 orë
<b>Tema 10</b>	Reklama në sektorin e shërbimeve turistike.	5 orë

#### 4. Lënda “Estetika dhe shërbimet speciale në restorant dhe bar” (L-13-167-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Estetika dhe shërbimet speciale në restorant dhe bar”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Estetika dhe shërbimet speciale në restorant dhe bar”, kl. 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë rëndësinë e estetikës në shërbimin e ushqimit dhe pijeve.
- Të dallojnë bazat dhe derivatet e ngjyrave.
- Të dallojnë raportet e ngjyrave bazë në krijimin e ngjyrave të reja.
- Të shpjegojnë ndikimin e natyrës në krijimin e ngjyrave;
- Të dallojnë rëndësinë e ngjyrave në dekorimin sallës, në dekorimin e vitrinave, bufeve si dhe në dekorimin e ushqimeve dhe pijeve.
- Të dallojnë ndikimin e stinëve dhe ngjyrave të stinës në dekorimin e sallave si dhe të ushqimit dhe pijeve.
- Të dallojnë ndikimin e tonalitetit, të dritës dhe errësirës në dekorimin e sallës së barit dhe restorantit;
- Të shpjegojnë ndikimin e ngjyrave në emocionet e klientit.
- Të shpjegojnë krijimin e gëzimit dhe entuziazmit nga ngjyrat e forta.
- Të shpjegojnë krijimin e pesimizmit nga ngjyrat monotone.
- Të dallojnë ndikimin mjediseve me dritë dhe ngjyra të ndryshme, në emocionet e klientit.
- Të dallojnë llojet e aksesorëve që mund të përdoren për dekorime në sallat e restorantit, barit, në dekorimin e bufeve të ushqimeve, vitrinave, tavolinave, të pjatave të ushqimeve dhe të pijeve;
- Të dallojnë rregullat e organizimit artistik të formave, ngjyrave, masave në rastet e organizimit, dekorimit të sallës, pjatës, etj.
- Të dallojnë rëndësinë e kontrastit të formave, masave, ngjyrave në rastet e organizimit, dekorimit të sallës, pjatës, etj.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe veçoritë e aktiviteteve katering.
- Të dallojnë kushtet për kryerjen e aktiviteteve katering.
- Të shpjegojnë mënyrat e organizimit dhe të shërbimit të personelit në rastet e pritjeve dhe banketeve përmes fletëve funksionale dhe rradhës së shërbimit;
- Të dallojnë forma të ndryshme të ofertës së aktiviteteve katering;
- Të shpjegojnë rëndësinë, llojin dhe organizimin e punëve përgatitore për një banket.
- Të dallojnë llojet e bufeve dhe punët përgatitore për realizimin e tyre.
- Të shpjegojnë mënyrat e llogaritjes dhe organizimit të pjatancave në bufe.
- Të skicojnë plane të organizimit të sallave në raste të aktiviteteve katering me tematika të ndryshme;
- Të skicojnë ide në lidhje me mënyra të ndryshme të dekorimit të sallave në varësi të llojit dhe tematikës së aktivitetit, llojit të klientëve, menusë, etj.
- Të shpjegojnë mënyra të organizimit dhe shërbimit në konferenca dhe seminare.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe historinë e barit.
- Të dallojnë llojet e bareve dhe karakteristikat e tyre.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e barit.
- Të dallojnë mjetet dhe pajisjet e barit.
- Të listojnë pijet baze të barit dhe karakteristikat e tyre;
- Të shpjegojnë kuptimin për masat në bar dhe llojet e tyre;

- Të shpjegojnë kuptimin dhe përdorimin e pijeve mikse në bar, bazat kryesore të tyre.
- Të dallojnë rëndësinë e dekorimit dhe ngjyrave të pijeve mikse në bar sipas llojit, përdorimit, stinës, etj.
- Të shpjegojë llojet, veçoritë e shërbimeve në sy të klientit.
- Të shpjegojë rregullat e qëndrimit dhe sjelljes gjatë shërbimeve në sy të klientit;
- Të skicojë organizimin, dekorimin e pjatave të klientit sipas rregullave të estetikës.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Estetika dhe shërbimet speciale në restorant dhe bar”, kl. 12 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Kuptimi dhe rëndësia e estetikës artistike në shërbimin e ushqimit dhe pijeve.	1 orë
<b>Tema 2</b>	Rëndësia e ngjyrave në dekorimin e sallës, vitrinave, bufeve si dhe në dekorimin e ushqimit dhe pijeve.	2 orë
<b>Tema 3</b>	Bazat e ngjyrave, tonalitetet dhe derivatet e tyre.	4 orë
<b>Tema 4</b>	Ndikimi i natyrës në psikologjinë e ngjyrës	1 orë
<b>Tema 5</b>	Ndikimi i ngjyrave në emocionet e klientit.	2 orë
<b>Tema 6</b>	Aksesorët kryesorë që përdoren për dekorime të sallave, bufeve, vitrinave, tavolinave si dhe pjatave dhe ushqimeve.	2 orë
<b>Tema 7</b>	Organizimi i formave, ngjyrave, masave si një konceptim artistik në bar dhe restorant.	4 orë
<b>Tema 8</b>	Kontrasti i formave, ngjyrave, masave	3 orë
<b>Tema 9</b>	Kuptimi, rëndësia dhe llojet e aktiviteteve catering	2 orë
<b>Tema 10</b>	Organizimi dhe kushtet për realizimin e aktiviteteve të ndryshme	2 orë
<b>Tema 11</b>	Planifikimi dhe menaxhimi i personelit për realizimin e pritjeve dhe banketeve	2 orë
<b>Tema 12</b>	Fletët funksionale për realizimin e aktiviteteve catering	6 orë
<b>Tema 13</b>	Mënyrat e organizimit të sallës dhe punët parapërgatitore në rastet e banketeve, bufeve, koktejeve	2 orë
<b>Tema 14</b>	Planifikimi dhe realizimi i bufeve të ndryshme.	4 orë
<b>Tema 15</b>	Organizimi i menusë dhe pjatancave në bufe.	2 orë
<b>Tema 16</b>	Ndërtimi i bufesë dhe organizimi i shërbimit në bufe.	2 orë
<b>Tema 17</b>	Ofertat dhe mënyrat e organizimit të konferencave dhe seminareve.	4 orë
<b>Tema 18</b>	Skicimi i artistik i banketeve dhe pritjeve	3 orë
<b>Tema 19</b>	Llojet, veçoritë e bareve dhe personeli i barit	2 orë
<b>Tema 20</b>	Ndërtimin dhe funksionimi i barit	2 orë
<b>Tema 21</b>	Pajisjet dhe mjetet e punës në bar	2 orë
<b>Tema 22</b>	Pijet bazë në bar. Masat e pijeve në bar, llojet.	4 orë
<b>Tema 23</b>	Pijet mikse, dekorimet e tyre.	3 orë
<b>Tema 24</b>	Shërbimet speciale në sy të klientit sipas llojit.	2 orë
<b>Tema 25</b>	Rregullat e qëndrimit, sjelljes, komunikimit në shërbimet speciale në sy të klientit.	1 orë
<b>Tema 26</b>	Skicimi i pjatave në shërbimet speciale në sy të klientit.	4 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të detyruar të praktikës profesionale

### 1. Moduli “Përgatitja dhe gatimi i asortimenteve bazë në kuzhinë”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm

Profili: Kuzhinë-Pastiçeri

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kod</b>	<b>PËRGATITJA DHE GATIMI I ASORTIMENTEVE BAZË NË KUZHINË.</b>	<b>M-13-435-10</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer parapërgatitjen dhe ndarjen anatomike të mishit të të gjitha llojeve si dhe të gatujnë buljone të kthjellta, të shpendëve dhe peshkut, salca të errëta dhe të bardha bazë si dhe asortimente me to, gjithashtu nxënësit aftësohen të përgatisin brumë sfoliat dhe asortimente me të.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	69 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Hoteleri-Turizëm.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi bën ndarjen anatomike të mishit.</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit, mjeteve, pajisjeve të punës.</li><li>- Analiza e skemës së ndarjes anatomike të trupit të kafshës sipas llojit.</li><li>- Ndarja anatomike e viçit.</li><li>- Ndarja anatomike e lopës.</li><li>- Ndarja anatomike e gjedhëve.</li><li>- Ndarja anatomike e shpendëve.</li><li>- Paketimi, etiketimi dhe ruajtja e pjesëve të ndara të mishit.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes anatomike të mishit..</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatitë vendin, mjetet, pajisjeve të punës sipas rregullit;</li><li>- të analizojë skemën e ndarjes anatomike të trupit të kafshës sipas llojit;</li><li>- të bëjë ndarjen anatomike të viçit sipas rregullit;</li><li>- të bëjë ndarjen anatomike të lopës sipas rregullit;</li><li>- të bëjë ndarjen anatomike të gjedhëve sipas rregullit;</li></ul>	

- të bëjë ndarjen anatomike të shpendëve sipas rregullit;
- të paketojë, etiketojë dhe ruajë pjesët e ndara të mishit sipas llojit dhe mënyrës së përdorimit.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ndarjes anatomike të mishit.

## **RM 2 Nxënësi gatuan bulion të kthjellët.**

### ***Përmbajtja:***

- Analiza e recepturës së bulionit të kthjellët.
- Përzgjedhja e mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e lëndëve të para.
- Peshimi i lëndëve të para.
- Larja dhe pastrimi i lëndëve të para.
- Hedhja në enë e mishit të grirë për bulion të kthjellët.
- Përzjerja e të bardhave të vezës me mishin e grirë, me erëzat dhe me ujin.
- Pjekja e qepëve në zgarë.
- Prerja e karrotave dhe majdanozit.
- Përzjerja e të gjithë përbërësve dhe ujit.
- Mbikqyrja e masës së përgatitur për procesin e filtrimit.
- Hedhja e “masës tërheqëse” në bulionin e zakonshëm.
- Mbikqyrja e procesit të zjerjes dhe kthjellimit të bulionit.
- Vlerësimi i organoleptik i bulionit të kthjellët.
- Ftohja, ambalazhimi ose servirja e bulionit të kthjellët.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së bulionit të kthjellët.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë recepturën e bulionit të kthjellët sipas rregullit;
- të përzgjedhë drejt mjetet e duhura të punës për parapërgatitjen e bulionit të kthjellët;
- të bëjë përzgjedhjen e lëndëve të para sipas recepturës.
- të bëjë peshimin e saktë të lëndëve të para, sipas recepturës.
- të bëjë larjen dhe pastrimin e lëndëve të para.
- të bëjë hedhjen në enë të mishit të grirë për bulion të kthjellët.
- të bëjë përzjerjen e duhur të të bardhave të vezës me mishin e grirë, me erëzat dhe me ujin.
- të bëjë pjekjen e duhur të qepëve në zgarë.
- të presë karrotat dhe magdanozin në përmasat e duhura.
- të përziejë sa duhet të gjithë përbërësit dhe ujin.
- të bëjë mbikqyrjen e masës së përgatitur për procesin e filtrimit.
- të hedhë “masën tërheqëse” në bulionin e zakonshëm.
- të mbikqyrë procesin e zjerjes dhe të kthjellimit të bulionit.

- të bëjë vlerësimin organoleptik të bulionit të kthjellët.
- të bëjë ambalazhimin ose servirjen e bulionit të kthjellët.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të bëjë pastrimin e vendit të punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së bulionit të kthjellët.

### **RM 3 Nxënësi gatuan bulion me shpendë.**

#### ***Përmbajtja:***

- Analiza e recepturës së bulionit të shpendëve.
- Përzgjedhja e mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e lëndëve të para.
- Peshimi i lëndëve të para.
- Larja dhe pastrimi i lëndëve të para.
- Coptimi i mishit të shpendëve me kocka.
- Hedhja në tenxhere e mishit të shpendëve me kocka.
- Coptimi i perimeve.
- Shtimi i ujit, perimeve, erëzave dhe aromave.
- Zjerja e përbërësve të bulionit.
- Kullimi i bulionit.
- Vlerësimi i organoleptik i bulionit me shpendë.
- Ftohja, ambalazhimi ose servirja e bulionit me shpendë.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së bulionit me shpendë.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë recepturën e bulionit të shpendëve sipas rregullit;
- të përzgjedhë drejt mjetet e duhura të punës për parapërgatitjen e bulionit të shpendëve;
- të bëjë përzgjedhjen e lëndëve të para sipas recepturës.
- të bëjë peshimin e saktë të lëndëve të para, sipas recepturës.
- të bëjë larjen dhe pastrimin e lëndëve të para
- të coptojë në përmasat e duhura mishin e shpendëve me kocka.
- të bëjë hedhjen në tenxhere të mishit të shpendëve me kocka.
- të coptojë perimet në përmasat e duhura.
- të shtojë sasi të duhura të ujit, perimeve, erëzave dhe aromave.
- të mbikqyrë zjerjen e përbërësve të bulionit.
- të bëjë kullimin e bulionit.
- të bëjë vlerësimin organoleptik të bulionit me shpendë.
- të bëjë ambalazhimin ose servirjen e bulionit me shpendë.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.

- të bëjë pastrimin e vendit të punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së bulionit me shpendë.

#### **RM 4 Nxënësi gatuan bulion me peshk.**

##### ***Përmbajtja:***

- Analiza e recepturës së bulionit të peshkut.
- Përzgjedhja e mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e lëndëve të para.
- Peshimi i lëndëve të para.
- Larja dhe pastrimi i lëndëve të para.
- Coptimi i perimeve.
- Hedhja në tenxhere me ujë e peshkut, mbetjeve të peshkut, perimeve, erëzave dhe aromave.
- Zjerja e përbërësve të bulionit me peshk.
- Kullimi i bulionit.
- Kthjellimi me masë tërheqëse.
- Vlerësimi i organoleptik i bulionit me peshk.
- Ftohja, ambalazhimi ose servirja e bulionit me peshk.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së bulionit me peshk.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë recepturën e bulionit të peshkut sipas rregullit;
- të përzgjedhë drejt mjetet e duhura të punës për parapërgatitjen e bulionit të shpendëve;
- të bëjë përzgjedhjen e lëndëve të para sipas recepturës.
- të bëjë peshimin e saktë të lëndëve të para, sipas recepturës.
- të bëjë larjen dhe pastrimin e lëndëve të para
- të coptojë perimet me përmasat e duhura.
- të hedhë në tenxhere me ujë sasi të duhura të peshkut, mbetjeve të peshkut, perimeve, erëzave dhe aromave.
- të mbikqyrë zjerjen e përbërësve të bulionit me peshk.
- të bëjë kullimin e bulionit me peshk.
- të bëjë kthjellimin me masë tërheqëse
- të bëjë vlerësimin organoleptik të bulionit me peshk.
- të bëjë ambalazhimin ose servirjen e bulionit me peshk.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës.
- të bëjë pastrimin e vendit të punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së bulionit me peshk.

#### **RM 5 Nxënësi gatuan supë të kthjellët dhe supa të tjera me bulion të kthjellët, të shpendëve dhe të peshkut.**



***Përmbajtja:***

- Analiza e recepturës së supës.
- Përzgjedhja e mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e lëndëve të para.
- Peshimi i lëndëve të para.
- Larja dhe pastrimi i lëndëve të para.
- Coptimi i perimeve.
- Hedhja e bulionit në tenxhere.
- Parapërgatitja e garniturave për supë të kthjellët (bukë e thekur, profiterole, raviole, fidhe, etj) dhe supat e tjera.
- Zjerja, kavërdisja ose pjekja e garniturës, apo supës.
- Servirja e supës së kthjellët me garniturën përkatëse.
- Servirja e supave të tjera.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së supës së kthjellët.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë recepturën e supës sipas rregullit;
